**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**14 Nr. 1094/24**
**Dt. 19.12.2024**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtime nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim edhe të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese, më **dt. 19.12.2024** merë:

## VENDIM

Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Titulli: Dekorimi i qytetit me drita dekorative për festa. Kodi intern i procedurës VU644-24-11541-2-2-1**, si vijon :

**z. Sabri Daliku**, caktohet menaxher i kontratës
**z. Benjamin Shala** caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës,

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës.

**Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :**

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e perfomancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktuesi i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do ti krijohet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim mes Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës , Menaxheri i Projektit do ti lëshoi Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësive të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644 – 24 – 11541 – 221/C999**
**14 Nr. 1089/24**
**Dt. 18.12.2024**

**KONTRATË SHËRBIMI**
**( Kontratë Kornizë )**

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik**(në tekstin e mëtejmë **PORORSITËSI)** , dhe

2. **" Hetem Tërllabuqi B.I."emri i biznesit/ NNP" Elektro"** me seli në **Vushtrri**, me **ARBK: 810689888** **si Operator Ekonomik**, të cilën e përfaqëson **z. Hetem Tërllabuqi**, në tekstin e mëtejmë **KONTRAKTUESI – KRYESI I SHËRBIMIT**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontrate publike kornizë për ekzekutimin e shërbimeve, si vijon:

**Shërbime të Dekorimit të qytetit me drita decorative për festa, me numër** identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i Prokurimit** | VU644 | 2 | 4 | 115 | 4 | 1 | 2 | 2 | 1 |
| **Nr. i brendshëm** | VU644 | 2 | 4 | 0 | 9 | 6 | 2 | 2 | 1 |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Shërbime të Dekorimit të qytetit me drita decorative për festa, për nevoja të A.K. - Vushtrri** sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. **prokurimi: VU644-24-11541-2-2-1 dhe nr. të brendshëm : VU644-24-096-221**

1.2 **Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari ditën e nesërme pas nënshkrimit të kontratës, respektivisht nga data 19.12.2024 dhe përfundon më dt. 18.02.2027 duke përfshirë edhe këtë datë.**

1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim dhe / ose ekzekutim të shërbimeve me sasitë e tyre përkatëse.

1.4 Sasitë e parapara, si në pjesën II. Lista e Çmimeve, ( pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve ) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mundë të lejohet një mospërputhje e cila nuk mundë të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind ( 30 % ).

1.5 **Nëse Urdhërblerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.**

**fillojnë dhe përfundohen ashtu sikurse është përshkruara në Seksionin II – Fleta e të Dhënave të Tenderit ( FTD ) NENI 5.4 – Lloji i Kontratës, Kërkesat dhe / ose /Kushtet e dërgesës dhe / ose kushtet e Kontratës.**

**Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
(f) Plani për menaxhimin e kontratës;
(g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[2] në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues: Komuna Vushtrri**

**Për Kontraktuesin : NNP " Elektro " - Vushtrri**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | **Ilmi Azemi** | **Emri:** | **Hetem Tërllabuqi** |
| **Pozita:** | drejtor | **Pozita:** | drejtor |
| **Nënshkrimi:** | | **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 18.12.2024 | **Data:** | 18.12.2024 |
| **Vula:** | | **Vula:** | ELEKTRO |

[2] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Nr i prokurimit , Nr i brendshëm , Titulli: Dekorimi i qytetit me drita dekorative për festa

**Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, a[illegible] formatin ~~0%, 8% apo 18%,~~ Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes d[illegible]**

| Nr. | Përshkrimi i pozicioneve | Njësia Matëse | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSH | Norma e TVSH-së në % | Çmimi për njësi (me TVSh)-€ | Totali (Pa TVSH) | TVSH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Vërejtje: Pozicionet e mëposhtme nënkuptojnë zbukurimin e qytetit me dekore, me materiale vetanake të operatorit ekonomik, për shfrytëzim vetëm për kohën festave të fundvitit, të cilat operatori ekonomik - i sjell, i monton, i funksionalizon, i demonton dhe i merr përsëri prapa. Çmimi për çdo pozicion perfshin: Tran[illegible] montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit ne gjendje plotësisht funksionale, mirëmbajtjen, demontimin me kërkesë të organit mbikqyrës. Në çmim duhet të kalkulo[illegible] i terë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaritja e pozicioneve të bëhët sipas gjendjes së realizuar në teren.** | | | | | | | |
| **I** | **Dekorimi i qytetit me drita dekorative për festa** | | | | | | | |
| 1 | **Furnizimi montimi dhe mirëmbatja e portave hyrëse me formë të yllit me ngjyra të verdhë dekoruese sipas fotos me dimensione (4x4x4m). Një të vendoset në fillim të shetitores dhe një të vendoset në fund, dekorimi duhet të jetë i njejtë me atë në foton e bashkangjitur.**<br><br>**Vërejtje:**<br>**Porta hyrese ne forme te yllit duhet të jetë i punuar me drita ngjyrë të verdhë .Duhet të rrethohet me gyp ndriques LED llampa 230V ,kabëll prej gome,në 10 m duhet të jenë 100 llampa LED ku qdo e 10 dritë të jetë me blic me mbrojtje IP44.**<br> | copë | 15.00 | 84.75 | 18.00 | 100.00 | 1271.19 | 228.81 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | **Furnizimi, montimi i portave me drita si dhe mirëmbajtja e dritave dekoruese me formë si në foto, për vendosje nga shtylla në shtyllë sipas fotos.**<br>**Vërejtje:**<br>**Të jenë me rrjetë ndriçuese ≥220V . LED llambat, blic dhe me mbrojtje IP44. Duhet të varen me litare metalik ne pozite horizontale.**<br>**Ngjyra e verdhë e ngrohtë.**<br><br> | **copë** | 20.00 | 16.95 | 18.00 | 20.00 | 338.98 | 61.02 |
| 5 | **Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e harpave dekoruese – ndriçues me ngjyrë të verdhë të ngroht (55x130cm) `dhe topa me ngjyrë të kuqe (15-20cm)**<br>**Vërejtje:**<br>**Duhet të jenë me konstruksion metalik. Të mbulohet me rrjetë ndriçuese ≥220V me kabllo prej gome. LED llambat duhet të jenë në rrjetë ,blic dhe me mbrojtje IP44. Duhet të përforcohen me sajlla speciale.**<br> | **copë** | 20.00 | 25.42 | 18.00 | 30.00 | 508.47 | 91.53 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | **Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e bredhit sipas fotos me gjatësi prej 7.50m me diametër 3.0 m. Bredhi fillimisht duhet të ketë konstruksion metalik, të mbështillet me rrjetë të gjelbërt të mbylltë, pastaj të dekorohet me degë të bredhit të cilat janë imitim degëve të bredhit natyror (dendësia e degëve duhet të jetë 15cm për aks).**<br>**Vërejtje:**<br>**Vendosja e bredhit caktohet nga organi mbikqyres.**<br> | copë | 1.00 | 847.46 | 18.00 | 1000.00 | 847.46 | 152.54 |
| 9 | **Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e rrjetës dekoruese-ndriçuese me ngjyrë të verdhe te ngrohtë, të cilat do të vendosen tek pjesa e bredhit,ne muri te kalas se vj.,dhe te ndoni objekt institucional-komuna.**<br><br>**Vërejtje:**<br>**Pjesa e sipërme të punohet me gyp ndriçues LED llampa ≥220V dhe të pjesa tjetër me rrjetë ndriçuese ≥220V me kabllo prej gome ,blic dhe me mbrojtje IP44. .**<br> | m' | 2100.00 | 4.24 | 18.00 | 5.00 | 8898.31 | 1601.69 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | **d) Shirit dekorues rreth e perçark bredhit.(Një komplet duhet ti ketë minimum 12 copë)**<br><br> | **Komplet për 1 Bredh m'** | 20.00 | 8.47 | 18.00 | 10.00 | 169.49 | 30.51 |
| 14 | **e) Rrethoja e bredhit dekorativ sipas figurës. Rrethoja e bardhë nga druri vendoset pergjatë gjithë perimetrit të berdhit me distancë 1m nga bredhi. Në pjesën e sipërme të dekorohet me degë sikur në foto.**<br>**Vërejtje:**<br>**Në çmim duhet të llogariten edhe pjesët dekorues për rrethojë të bredhit me shirit të gjelbër.**<br><br> | **Komplet për 1 Bredh (copë)** | 1.00 | 16.95 | 18.00 | 20.00 | 16.95 | 3.05 |
| 15 | **f) Furnizimi dhe montimi I elemente dekorative per festen e Ramazanit. (Një komplet duhet ti ketë minimum 12 copë)**<br><br> | **Komplet (copë)** | 5.00 | 169.49 | 18.00 | 200.00 | 847.46 | 152.54 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | Furnizimi dhe montimi I shtyllave metalike me gjatësi 3.5 m dhe prerje tërthore 60x60x3 mm, duke perfshirë montimin dhe ankerimin e tyre në murin me gurë, për mbajtjen e sajlleve për vendosjen e ndriçimit dekorues. Në këtë pozicion hyjn edhe furnizimi dhe montimi i sajlleve të çelikut në drejtim gjatësorë dhe tërthorë në të cilat do të montohet ndriçimi dekorues. Shtyllat e ndriçimit publik janë të vendosur çdo 40m. | copë | 7.00 | 8.47 | 18.00 | 10.00 | 59.32 | 10.68 |
| TOTALI I PERGJITHSHEM ME TVSH | | | | | | | 28,050.85 | 5,049.15 |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|---|
| EMRI I OE: | |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | |
| NËNSHKRIMI: | |
| DATA: | |
| VULA: | |